

**KONTRATE THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Green Clean " sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me date 17.06. 2022 (dymije e njezet e dy) u mblodhën shtetasit:

Olger Stillo, i biri i Kostaq, i dtl.15.01.1989, banues ne Tirane, madhor me zotesi të plote per të vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me Nr.032615024.

Te cilet me cilesine e " Ortakut ", redaktoi aktin e themelimit, nepemjet te cilat deklaron se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise, ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me perjegjesi të kufizuar, me emertimin " **Green Clean** " sh.p.k.

KREU I
Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i Shoqërisë është "**Green Clean**" sh.p.k..

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "**Green Clean**" sh.p.k., eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personat fizikë dhe juridike te siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka selinë ne Tiranë, Yzberisht Rruga Migjeni, Ndertesa 11, Hyrja 11, Apartamenti 35, Zona Kadastrale 3866, Volumi 78, faqe 95

Olger Stillo

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

Ndertime civile dhe ekonomike, ndertime civile, industriale turistike, bujqesore deri ne 5 kate. Ndertime civile, industriale turistike bujqesore mbi 5 kate, rikonstruksione, ndertim banese me skelet mbi 8 kate. Ndertime rrugore, ndertim rruge kategoria IV dhe V, ndertim rruge kategoria III dhe II. Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore. Ndertim autostrade -pista -aeroporte helioporte. Ndertim hekurudhore, punime hekurudhore, punime speciale te shinave dhe traversave, punime ne sistemin elektrik dhe te sinjalizimit. Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 m, ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m - Ekstakada-ura metalike -te varura, ndertim tunele rrugore - hekurudhore, ndertime detare, ndertime portuale -bankina - basene - pontile, punime thellimi-drenimi. Ndertime hidraulike e hidroteknike, ndertime ujsjelles, kanalizime, kanale e impiante vadirje, punime mbrojtje te sistemit hidraulik-cimentime etj. Ndertim impiante te sistemit te ujit, ndertim vajsjelles, gazzjelles, naftesjelles, ndertim digadamba deri ne 10 m, ndertim galeri- tunele, ndertim diga te larta. Vepra te vecanta punime speciale, sillose, kulla, kulla 2 uji etj, B/armi metalike, perforcime themeli e punime nentokesore, izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat, themele te vecanta, puse shpime gjeologo- inxhinierike, cpime per uje. Punime restaurimi, restaurim i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike. Punime karpenterie. Punime sherbimi, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe -pyll parqe, pastrimi i siperfaqeve urbane, mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane -ndricimi e sinjalizimi urban. Shfrytezim te mineraleve te grupit 1,11,111,1V, ne karieren e punimeve nentokesore, perdorimin civil te lendeve plasese ne objektet qe punon, nxjerjen dhe perpunimin e gurit gelqeror duke prodhuar te gjitha llojet e rerave te suvatimit, etj. Prodhim, perpunim, ruajtje konservim dhe paketim te produkteve bujqesore dhe blektorale. Gumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, perpunim apo asgjesim i mbetjeve te llojeve te. Ndertim i linjave te shfrytezimit dhe pasurimit te ujit te pijshem si dhe tregtimit te tij. Sherbime pastrimi te ambienteve te rendshme dhe te jashtme she sherbime DDD (Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) si dhe tregtim materialesh pastrimi. Krijimin e stacioneve komplekse te servisit per te gjitha llojet e sherbimeve riparim te automjeteve te ndryshme, larje dhe pastrim mjetesh motorike; rregullime dhe lyerje me boje, ndertimi i stacioneve te furnizimit me karburantit, pastrim larje sprucim ose veshje e mbetjeve te ambalazheve, magazinim dhe trajtim i mbetjeve te ujerave te zeza urbane, tregtimi e materialeve te ndertimit te produhuara nga shfrytezimi perpunimi dhe prodhimi i burimeve minerale, mermereve, graniteve gur dekorativ etj. Prodhim asfalti, prodhim betoni, prodhim parafabrikate betoni. Projektim ne fushen e ndertimit. Veprintari e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjesdis. 3 Auditim mjesdisor. Shitje-blerje automjetesh, autovetura, eskavator, kamiona, kamioncina, import-eksport, makineri te renda etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Olcje Stello


Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoquerise eshte 100.000 leke dhe eshte i perbere nga 1 kuote

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i shoquerise perkatesisht:

-Olger Stillo, zoterues i 1 kuote, qe perfaqesojne 100 % te kapitalit themeltar te shoquerise, me vlerë te pergjithshme 100.000 leke,

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoquerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoquerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoquerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Olger Stillo

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të ąsamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpérndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpérblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi



Shoqeria do te administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqerise eshte Z. Olger Stillo, i cili do te ushtroje funksionet ne kete detyre per një periudhe 5 vjecare me te drejte riparteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

d) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpala asamblesë së përgjithshme për miratim;

dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) Administratori ne respekt te dispozitave ligjore, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jne te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishmeper te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete.

f) raportojë përpala asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur : Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpala të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në



emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtar për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16


Dispozita perfundimtare

Olcu Stills

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "**Green Clean**" sh.p.k. u nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

O R T A K U

Olger Stillo

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Olger Stillo". The signature is fluid and cursive, with the first name above the last name. To the right of the name is a long, stylized blue ink flourish or underline.